

FJALA E DEPUTETES KLOTILDA BUSHKA

E HËNË 16 MAJ 2022

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në zbatim të pikës 2, të nenit 109, të Rregullores së Kuvendit dhe vendimit nr. 9 të vitit 2022 të Konferencës së Kryetarëve, shqyrtoi në një mbledhje të posaçme sot çështjen sipas rendit të ditës, për sa i takon raundit të parë për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Komisioni konstatoi se deri në afatin e përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve nuk është depozituar asnjë kandidaturë në Kuvendin e Shqipërisë.

Në këto kushte, Komisioni, në zbatim të nenit 87, pika 2, të Kushtetutës, i cili përcakton se votimi i parë zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga fillimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit dhe votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat, i paraqet seancës plenare për informim këtë raport, me qëllim përmbylljen e procedurave për votimin e raundit të parë për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, siç e thashë, pa kandidat. Faleminderit!